

Rezime

Në këtë fushë të studimit, pa dyshim se kërkimet nisin nga fenomenet e prozës shqipe në përgjithësi, për të arritur në veçantinë e kësaj proze, pikërisht me autoret bashkëkohore shqiptare.

Veprat e autoreve bashkëkohore shqiptare jo vetëm që bartin vlera letrare, por sjellin edhe një pamje të re në horizontin e letërsisë, sa i takon tematikës, motiveve, ideve, gjuhës, stilit etj.

Në këtë studim janë bërë përpjekje për për të hyrë në esencën e kësaj proze, për të nxjerrë karakteristikat kryesore të saj, modelet dhe përbërësit, dukuritë, botën e personazheve, realitetin, imagjinatën.

Pasi proza ekzistencën e kërkon në formë, atëherë veprat do të trajtohen nga pikëshikimi i analizës së formës, për të nënkuptuar natyrën e veçoritë e saj.

Objekti i kërkimit pasqyrohet me përpjekjen studimore, për të depërtuar në analizën e tekstit, në nxjerrjen e kuptimeve dhe domethënive kryesore të tij, për të fuqizuar vlerën themelore të prozës së autoreve kryesore. Veçantia e kësaj proze e ka veçantinë e autoreve, pra individualitetin e tyre krijues. Këtu fillon të krijohet shpalosja e dimensionit të njohjes dhe vlerësimit për vepra të caktuara.

Punimi fillimisht bën evidentimin e tipareve karakterizuese të prozës, e cila i mungonte letërsisë sonë në këtë formë. Së dyti, përfshihet një letërsie e krijuar në fund të shek.XX , duke vazhduar edhe sot si letërsi bashkëkohore, çka do të thotë se brenda punimit krijohet një marrëdhënie përgjasuese e këtij çifti binomik të letërsisë. Së treti përmes këtij studimi, sadopak lexuesi mund të ketë në dorë një shkrim përmbledhës lidhur me romanet më të rëndësishme të gjashtë autoreve.

Faktet dhe argumentet nuk kanë për qëllim të mbështeten te një lloj kritike feministe, por të përqendrohen te vlera letrare dhe estetike.

Duke ofruar njohuri për fillimin dhe zhvillimin e prozës shqiptare janë paraqitur fakte dhe argumente që tregojnë etapat dhe periudhat e konstituimit të prozës nga periudha e romantizmit, në periudhën midis dy luftërave botërore, në periudhën e fillimeve të modernitetit të prozës shqiptare, për të arritur deri te autoret e prozës bashkëkohore shqiptare.

Tiparet e kësaj proze përqendrohen në një dimension të ri kuptimor dhe estetik, i cili degëzohet drejt

Resume

In this field of study, research is undoubtedly initiated by the phenomena of Albanian prose in general, to reach the uniqueness of this prose, precisely with contemporary Albanian authors.

The works of contemporary Albanian authors not only convey literary values, but also bring a new perspective to the horizon of literature in terms of themes, motives, ideas, language.

In this paper, attempts have been made to get into the essence of this prose, to draw out its main features, patterns and components, phenomena, the world of characters, reality, and imagination.

As prose requires existence in form, then works will be treated from the point of view of form analysis, to imply its nature and features.

The object of the research is reflected in the research effort, to penetrate the text analysis, to extract its main meanings, to reinforce the fundamental value of the main authors' prose. The peculiarity of this prose is the uniqueness of the authors, their creative individuality. This is where the recognition and appreciation dimension of certain works begins to unfold.

The paper firstly identifies the characteristic features of prose that lacked our literature in this form. Secondly, it includes a literature created at the end of the 20th century, continuing today as contemporary literature, which means that within the work, a resonant relationship of this binomial pair of literature is created. Thirdly, through this study, the reader may have access to a summary of the most important novels of the six authors.

The facts and arguments are not intended to be based on a kind of feminist critique, but to focus on literary and aesthetic values.

Providing insights into the beginnings and development of Albanian prose, facts and arguments are presented showing the stages and periods of prose constitution from the period of Romanticism, between the two world wars, the period of the beginnings of modern Albanian prose to the authors of contemporary Albanian prose.

The features of this prose focus on a new meaning and aesthetic dimension, which branches towards the principles of modernity and postmodernism.